



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2011-08

Anton Rruka

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Vergina MICHEVA-RUSEVA, anëtare zëvendësuese

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 12 prill 2011.
2. Kjo ankesë lidhet me procedurat pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tutje: DhVGjS). Znj. Bednarek është anëtare e Panelit dhe gjithashtu gjykatëse e EULEX-it, e cila punon në DhVGjS. Prandaj znj. Bednarek nuk mund të merr pjesë në

shqyrtimin e këtij rasti si anëtare e Panelit. Ajo është zëvendësuar nga znj. Micheva-Ruseva, e cila është anëtare zëvendësuese.

II. FAKTET

Faktet e rastit

3. Parashtruesit të ankesës tani për tani e ka një rast të pazgjidhur në DhVGjS.
4. Më 4 prill 2011 DhVGjS ka lëshuar një urdhër, duke kërkuar nga parashtruesi i ankesës, në përputhje me Nenin 25.7 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6, të ofroj përkthimin e kërkesës (dhe) të të gjitha dokumenteve përcjellëse në gjuhën angleze brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve.
5. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i ankesës kishte nënshkruar “vërtetimin mbi pranimin e një dokumenti” përkatës.

Legjislacioni përkatës

6. Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kapitulli II, neni 2.1 thotë si më poshtë:

Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi që të ushtrjnë funksionet për lëndët që janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave ku ata janë caktuar nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX-i KOSOVË.

III. ANKESAT

7. Parashtruesi i ankesës pretendon, duke i përmendur deklaratat dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, se është diskriminuar. Ai pretendon se pamundësia që të komunikoj me DhVGjS në gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare në Kosovë, shpie drejt diskriminimit dhe se e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur.

IV. LIGJI

8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
9. Siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të

drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

10. Sipas Rregullores së përmendur, dhe bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
11. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës, në thelb, kërkon që Paneli të ndërmerr masa në mënyrë që të pengoj DhVGjS që të zbatoj Nenin 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 gjatë procedurave në DhVGjS (një institucion i Kosovës).
12. Për më tepër, Paneli vëren se rasti i parashtruesit të ankesës është i pazgjidhur pranë DhVGjS. Paneli nuk ka kompetencë sa i përket fushës administrative dhe juridike të punës së gjykatave të Kosovës dhe legjislacionit që zbatohet nga to. Më tej, fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues në DhVGjS, e që janë të caktuar për ta shqyrtuar rastin, nuk ia heq DhVGjS karakterin e saj si pjesë e sistemit juridik të Kosovës.
13. Si rezultat, çështja e ngritur në këtë ankesë nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, *gjen* se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit